



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2592/ 2 prot.,

Datë 16.09.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Gentjan Kadriu*” PF në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me objekt Loti IV “*Blerje Ushqime Koloniale*” me Nr. REF-11540-06-28-2024, me fond limit: 637,906 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH ose 6,361 (gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 27.06.2024 është 100.28 lekë, zhvilluar në datën 12.08.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Gentjan Kadriu*” PF me NIPT K81630012E me adresa: Rruga “Siri Kodra”, Banesë Private, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, 1001, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “*M.C.CATERING*” SHPK me NIPT K72218022J me adresë: Rruga “Pjeter Budi”, Nd.29, H3, Ap.14, Njesia Administrative nr.2, 1010, Tiranë.

Në datë 13.09.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është depozituar ankesa elektronike me numër A/2024/4555, dhe me nr. 2592/2024 Prot., date 13.09.2024 e operatorit ekonomik “*Gentjan Kadriu*” PF, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me objekt Loti IV “*Blerje Ushqime Koloniale*” me Nr. REF-11540-06-28-2024, me fond limit: 637,906 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH ose 6,361 (gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas

Bankës së Shqipërisë datë 27.06.2024 është 100.28 lekë, zhvilluar në datën 12.08.2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Gentjan Kadriu” PF, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Gentjan Kadriu” PF:

- *Gentjan Kadriu S`kualifikohet Operatori ekonomik s`kualifikohet për arsye se:*

→ *Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk vërteton se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme artikujt objekt prokurimi. Për vërtetimin e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur fatura të ndryshme furnizimi, të cilat janë të gjitha për një produkt/artikull të vetëm “Jufka”, ndërkohë që referuar Shtojcës 6 për Lotin IV “Ushqime Koloniale” kërkohen mbi 20 artikuj ushqimorë të ndryshëm.*

→ *Nuk plotëson shkronjën a), të pikës 6, të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, lidhur me disponimin e 1 (një) stabilimenti, ne zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Licenca LN-7924- 05-2014 e paraqitur nga operatori ekonomik nuk ka si vend të kryerjes së veprimtarisë stabilimentin e deklaruar nga operatori ekonomik në kontratën e qerasë Nr. repertori 2717, Nr. koleksioni 1052, datë 10.08.2024. Gjithashtu, stabilimenti i deklaruar nga operatori ekonomik nuk është i regjistruar si vend i ushtrimit të aktivitetit as në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të operatorit.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.09.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri